



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 611 Prot.

Tiranë, më datë 26.12.2018

VENDIM

Nr. 529, datë 26.12.2018

PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR INTERESIN KULTUROR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, gërma d, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 26.12.2018, pasi shqyrtoi propozimin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të propozimit të DRTK Korçë dhe DRTK Durrës për vendosjen në “Mbrojtje Paraprake” të objekteve me qëllim vërtetimin e interesit kulturor të tyre sipas listës bashkëlidhur”.
 - *Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me DRTK-të përkatëse të marrin masa për vazhdimin e procedurave të verifikimit të interesit kulturor.*
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Mirela KUMBARO FURXHI

